REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PRRENJAS
KOMISIONI I STREHIMIT

Në kuadër të programit **"BANESË ME KOSTO TË ULËT, ME KREDI TË LEHTËSUAR NGA BUXHETI I SHTETI NËPËRMJET PROJEKTIT TË SUBVENCIONIMIT TË INTERESAVE TË KREDISË"**, Bashkia Prrenjas ju njofton se çdo qytetar mund të aplikojë duke paraqitur kërkesën pranë bashkisë duke dorëzuar dokumentacionin fizik ose duke bërë aplikim on-line në portalin e-albania përmes llogarisë së tyre personale duke zgjedhur shërbimin "Kërkesë për të përfituar nga programet e Strehimit Social" duke ngarkuar dokumentat e mëposhtme:

a) Për të dhëna personale të aplikantit:

i. çertifikatë e lindjes së aplikantit, me përjashtim të rasteve specifike kur individi/familja nuk ka regjistrim në gjendjen civile;
ii. vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkohet strehimi social, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit.

b) Për vërtetimin e kushteve të strehimit, sipas shkronjës "a", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":

i. vërtetim nga Agjensia Shtetërore për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes;
ii. vërtetim nga Agjensia Shtetërore për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj,kur banesa është me sipërfaqe nën normat e strehimit në fuqi;
iii. vërtetim nga Agjensia Shtetërore nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për çdo anëtar të familjes, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;
iv. vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrësqë aplikanti apo çdo pjestar tjetër i familjes në moshë madhore nuk ka aplikuar për legalizim banese.(origjinale)
v. aktverifikim nga njësia vendore për:
    a. banesat në rrezik shembjeje;
    b. rastet kur familja ka mbetur e pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;
    c. banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit.
vi. vendim i gjykatës për familjet që humbasin banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës;
vii. akt i verifikimit nga njësia vendore për familjet rome/egjiptiane, që banojnë në banesa individuale ose struktura, të cilat nuk klasifikohen si banesë.

c) Për vërtetimin e kushteve familjare, sipas shkronjës "b", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018,

"Për strehimin social":

i) certifikatë familjare;

ii) vendim i gjykatës që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara.

ç) Për vërtetimin e kushteve sociale, sipas shkronjës "c", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":

i. vërtetim i komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar për individë me aftësi tëkufizuara;
ii. vërtetim përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezë e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar për individët me statusin e jetimit;
iii. dokument që vërteton se ka mbetur i pastrehë si rezultat i lirimit të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuara;
iv. dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin "emigrant", "punëtor emigrant" dhe "azilkërkues";
v. dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të shtetit dhe të Policisë së Burgjeve;
vi. urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata për viktimat e dhunës në familje;
vii. vetëdeklarim nëse individi/familja i përket pakicës kombëtare rome ose egjiptiane;
viii. dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin;
ix. vetëdeklarim se i përket grupimit LGBTI;
x. vërtetim me certifikatë familjare se individi i përket kategorisë vajzë-nënë.

d) Për vërtetimin e kushteve ekonomike, sipas shkronjës "ç", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":

i. vërtetim i të ardhurave neto të familjes ose një deklaratë me shkrim nga aplikuesi për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, të cilat duhet t'i bashkëlidhen dokumenteve zyrtare që e vërtetojnë atë, përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;
ii. dokument nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen ekontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;
iii. vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;
iv. vërtetim nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;
v. vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit do të jetë deri më **24.05.2024**